



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi European



**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



**QENDRA KOMBËTARE BURIMORE**  
PËR **SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI**

# VLERËSIMI I KAPACITETEVE DHE NEVOJAVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

## Raport Vlerësimi





# VLERËSIMI I KAPACITETEVE DHE NEVOJAVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Tiranë, Shqipëri 2024

## Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Email: [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org)

Website: [www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)

## Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile

Email: [info@resourcecentre.al](mailto:info@resourcecentre.al)

Website: [www.resourcecentre.al](http://www.resourcecentre.al)

Rruga e Elbasanit, Godina Park Gate, Kati I 10-të,

Ap. 71 / 73, PO BOX 2418/1

Kodi Postar 1010, Tirana, Albania

Tel: +355 4 2254881

## Përgatitur nga:

Xhoana Zeqo

## Grafika dhe faqosja:

Regana Hysenbelli

Ky raport është realizuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Informacioni dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian. As institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian, as cilido person që vepron në emër të tyre, nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimin që mund të bëhet nga informacioni që përmban ai.

Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri falenderojnë të gjitha organizatat për bashkëpunimin dhe përfshirjen në realizimin e këtij studimi.



## HYRJE

Ky vlerësim u realizua nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, një platformë për shoqërinë civile në nivel kombëtar e lokal, në mbështetje të fuqizimit të kapaciteteve të sektorit, nxitjes dhe lehtësimit të dialogut në politikëbërje dhe përpjekjeve advokuese për një mjedis mundësues.

Qendra është një nismë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, e nisur në vitin 2019, e cila zbatohet në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA), me mbështetjen e Bashkimit Evropian.

Vlerësimi synon të identifikojë nevojat aktuale të organizatave për rritje kapacitësh në fushën e manaxhimit organizativ, qendrueshmërisë financiare, pjesëmarrjes në politikëbërje, procesit të integritimit Evropian, transparencës, bashkëpunimit me median dhe biznesin privat. Nevojat e identifikuar do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e programeve të ardhshme për rritje kapaciteti nga Qendra Kombëtare Burimore në shërbim të sektorit të shoqërisë civile. Gjetjet e vlerësimit gjithashtu mund t'u vijnë në ndihmë organizatave, donatorëve dhe institucioneve të tjera që punojnë për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit në vend.

Për hartimin e këtij raporti, Qendra Kombëtare Burimore ndërmorri një vëzhgim online nëpërmjet një pyetësi gjysmë të strukturuar, shpërndarë dhe plotësuar nga organizata të shoqërisë civile (OSHC) përgjatë muajit *dhjetor 2023 - janar 2024*. I organizuar në 6 seksione kryesore, pyetësi synonte identifikimin e nevojave për trajnim dhe asistencë mbi aspekte kyçe zhvillimore të organizatave të shoqërisë civile dhe veprimtarisë së tyre si: (1) qeverisjen organizative, zhvillimin dhe manaxhimin organizativ (2) pjesëmarrjen në politikëbërje dhe përfshirjen e organizatave në nisma advokuese (3) pjesëmarrjen e organizatave në proceset e integritimit evropian (4) transparencën e OSHC-ve me publikun (5) komunikimin dhe bashkëpunimin OSHC-Media dhe (6) marrëdhënien me sektorin privat. 113 organizata nga të dymbëdhjetë qarqet e vendit, morën pjesë në këtë vëzhgim duke plotësuar pyetësin online dhe shprehur opinionet e tyre.

### *Kufizimet e vlerësimit*

Gjatë zhvillimit të raportit, si në mbledhjen e të dhënave dhe në shkrimin e raportit të vlerësimit kufizimet kryesore ishin: (1) numri i organizatave të përfshira, i cili megjithëse në dukje është i ulët në krahasim me numrin e organizatave që rezultojnë të regjistruara (2000+ OSHC të regjistruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve), është një kampion studimi përfaqësues sepse përfshin pjesën më të madhe të organizatave aktive në vend; (2) të dhënat e vetëraportuara nga OSHC-të. Vlerësimi i kapacitetit u bazua në informacionet e marra përmes një vëzhgimi online të përfaqësuesve të OSHC-ve dhe vetëdeklarimit të tyre për të gjitha çështjet. Në këto kushte, të dhënat e vetëraportuara kufizohen nga fakti që ato mund të jenë subjektive dhe nuk mund të verifikohen në mënyrë të pavarur.



# SHKURTIME

- BE** Bashkimi Evropian
- OSHC** Organizata të shoqërisë civile
- OJF** Organizata jofitimprurëse
- PSH** Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
- TVSH** Tatimi mbi Vlerën e Shtuar




## 113

organizata të shoqërisë civile (OSHC), rrjete dhe grupime informale OJF-sh, morën pjesë në vlerësim duke plotësuar pyetësonin online, nga qytete si Elbasan, Bulqizë, Durrës, Fier, Fushë Arrëz, Fushë Krujë, Gjirokastër, Korçë, Laç, Kurbin, Lezhë, Maliq, Orikum, Përmet, Peshkopi, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë, Tropojë, Vau i Dejës dhe Vlorë.


Pavarësisht kësaj shtrirje rreth **53%** e OSHC-ve të përgjigjura janë të vendosura në **Tiranë**, aty ku dhe dendësia e shtrirjes së organizatave jofitimprurëse në vend është më e madhe.

### Fushat e veprimtarisë së OSHC-ve\*


Fusha e veprimtarisë së OSHC-ve të përgjigjura rezultojnë të jetë e larmishme, me përfshirje dhe kontribut në më shumë se një sektor njëkohësisht. Sikurse vjet, fusha e veprimtarisë me të rinjtë dhe fëmijët dominon më së shumti, pasuar nga fushat e mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes sociale / shërbimeve sociale, të cilat kanë një rritje në përfaqësim krahasuar me raportin e vitit të shkuar.




### Forma e organizimit të OSHC-ve pjesëmarrëse



### Zona gjeografike e ushtrimit të aktivitetit të OSHC-ve\*



### Shpërndarja e OSHC-ve sipas vitit të themelimit






# TË DHËNA TË PËRGGJITHSHME RRETH OSHC-VE PJESËMARRËSE NË VLERËSIM

## Buxheti i OSHC-ve


Nga të dhënat e grumbulluara rezulton se buxheti vjetor i OSHC-ve varion nga 0 EUR deri në 1,000,000 EUR, nga ku pjesa më e madhe e OSHC-ve pjesëmarrëse në vlerësim (34%) punojnë me buxhete nga 20,001 deri në 100,000 EUR. Vetëm 9% e tyre raportojnë buxhete mbi 400,001 EUR-1,000,000 EUR. Asnjë nga këto OSHC-së nuk është e vendosur jashtë kryeqytetit.




Nëse krahasojmë nivelin e buxheteve të OSHC-ve sipas vjetërsisë së tyre, rezulton se organizatat me më shumë eksperiencë, themeluar kryesisht përgjatë 1995-2010, tentojnë të kenë buxhete mbi 100,001 EUR dhe vetëm 1 prej tyre deklaroi nivel buxheti më pak se 5,000 EUR. Nga ana tjetër, edhe pse më të pakta në raste, identifikohen OSHC me më pak se 10 vite eksperiencë, që raportojnë nivele buxheti mbi 400,001 EUR.

## sipas fushës së veprimtarisë për 5 fushat më të zgjedhura\*

Ndërkohë, nëse analizojmë nivelin e buxhetit për çdo fushë veprimtarie, OSHC-të që punojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit edhe pse një prej fushave me përfaqësim më të lartë në vlerësim, nuk raportojnë raste të OSHC-ve me nivel buxheti mbi 300,001 EUR, krahasuar me fushat e tjera të veprimtarisë me pjesëmarrje të lartë.



## sipas vjetërsisë






# TË DHËNA TË PËRGGJITHSHME RRETH OSHC-VE PJESËMARRËSE NË VLERËSIM

Gjetjet tregojnë se OSHC-të vijojnë të kenë larmishmëri në burimet njerëzore të angazhuara në organizata. Kështu, përveç të punësuarve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme, 70% e OSHC-ve deklarojnë se kanë kontraktuar ekspertë të jashtëm për mbarëvajtjen e programeve të tyre. Vullnetarët gjithashtu vijojnë të mbeten forcë mbështetëse në veprimtarinë e organizatave. 57% e OSHC-ve, kryesisht atyre që punojnë në fusha si fuqizimi i gruas dhe çështjet gjinore, zhvillimi i shoqërisë civile dhe vullnetarizmit, shëndeti dhe kujdesi shëndetësor, të rinjtë dhe fëmijët dhe shërbime ndaj personave me nevoja të veçanta, deklarojnë që kanë patur vullnetarë të angazhuar gjatë vitit 2023.


## Punësimi në sektor gjatë 2023



## Përfaqësimi gjinor i punonjësve të OSHC-ve



## Vlerësimi i kapaciteteve të stafit të OSHC-ve



## Vlerësimi i formave të aktiviteteve që zhvillojnë kapacitetet dhe rrisin njohuritë më produktive\*





Vetëm 22% e OSHC-ve deklarojnë që kanë aktualisht kapacitete të forta dhe mjaftueshme të stafit për të punuar për arritjen e misionit dhe objektivave të organizatës. Pjesa dominante e tyre vlerëson se ka nevojë për rritje kapacitetesh në staf.

Në ndryshim nga raporti i mëparshëm, mentorimi dhe asistenca radhitet si forma më produktive e aktiviteteve që zhvillojnë kapacitetet dhe rrisin njohuritë, pasuar nga programet afatgjata të trajnim/leksion kombinuar me mentorim/asistencë dhe ndarja e eksperiencave, të cilat radhiteshin më parë si më produktivet.




## Çështje me interes për rritje kapacitetesh organizative për OSHC\*

Qendrueshmëria financiare vijon të jetë çështja me interes më të lartë në organizatat e shoqërisë civile për rritje kapacitetesh, pavarësisht vendndodhjes apo vjetërsisë së OSHC-ve.



## Çështje të kuadrit ligjor dhe fiskal me interes për rritje kapacitetesh\*



Legjislacioni tatimor, detyrimet fiskale, raportimi financiar, si dhe procedurat e rimbursimit të TVSH-së vijojnë të mbeten çështjet me interes më të lartë për programe të rritjes së kapacitetit mbi kuadrin ligjor dhe atë fiskal, kjo pavarësisht vendndodhjes së organizatave.



## Çështje të manaxhimit organizativ me interes për rritje kapacitetesh\*




Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në çështje të manaxhimit organizativ, monitorimi dhe vlerësimi i programeve/projekteve rezultojn si çështja me interesin më të lartë për OSHC-të për rritje kapacitetesh, pasuar nga hartimi i planeve strategjike dhe manaxhimi i burimeve financiare.

Politika dhe procedura për parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimin nga terrorizmi, komunikimi i brendshëm (respektivisht me nga 2%) si dhe sinjalizimi dhe antikorrupsioni (1%), rezultojnë çështjet me më pak interes për rritje kapaciteti.

Renditja dhe ky trend interesi nuk ndryshon edhe nëse krahasojmë të dhënat sipas vjetërsisë së organizatave.


## sipas vjetërsisë \*





## Çështje të qendrueshmërisë financiare të OJF-ve me më shumë interes për rritje kapacitetesh\*


Ngritja e fondeve dhe burimet e financimit për OJF-të, si dhe programet e financimit të BE-së, sërish rezultojnë si dy temat më me interes për rritje kapacitetesh në aspektin e qendrueshmërisë financiare të OSHC-ve, qofshin këto OSHC nga kryeqyteti apo jashtë tij.



## sipas vjetërsisë\*

E njëjta situatë paraqitet edhe nëse i krahasojmë nevojat e OSHC-ve në raport me fushën e tyre të veprimtarisë dhe vjetërsinë.

Ajo çfarë bie në sy në analizën e raportit nevoja - vjetërsi është se organizatat me eksperiencë në sektor vijojnë të kenë interes më të lartë kundrejt programeve të financimit të BE-së dhe ngritjes së fondeve.






## Përfshirja e organizatave në fushata advokacie gjatë 2023


68% e OSHC-ve pjesë e vlerësimit, pohojnë se kanë qenë të përfshira në fushata advokacie përgjatë 2023.

Kryesisht përfshirja e OSHC-ve ka qenë si pjesë e një grupimi organizatash, në 39% të rasteve, duke shënuar rritje të konsiderueshme krahasimisht me situatën në vitin e kaluar, ku mbizotëronte përfshirja e OSHC-ve në advokaci përmes fushatave zhvilluar nga vetë organizata. Nga të dhënat e vlerësimit nuk vihen re diferenca në pjesëmarrje në fushata advokaci bazuar në vendndodhjen e OSHC-ve.



## Përfshirja e organizatave në fushata advokacie gjatë 2023 sipas fushave të veprimtarisë\*

Nëse analizojmë përfshirjen e organizatave sipas fushës së veprimtarisë së tyre dhe formën e përfshirjes, vërehet se OSHC-të që punojnë kryesisht në fusha si shërbimet sociale, mbrojtja e mjedisit, zhvillimi ekonomik, zhvillimi rural dhe edukimi, përfshihen më shumë në fushata advokacie ndërmarrë nga një grupim organizatash, ndërsa organizatat që punojnë në fushën e kulturës, artit dhe shëndetit, rezultojnë më shumë të përfshira në fushata të ndërmarrë nga vetë ato. Organizatat e medias kanë përfshirje të njëjta në të dyja rastet.






## Vlerësimi i efektivitetit të fushatave të advokasisë

Efektiviteti i fushatave advokuese, ku OSHC-të pjesë e vlerësimit kanë marrë pjesë në një formë apo tjetër, në pjesën dërrmuese vlerësohet si *mesatarisht efektive* dhe *shumë efektive*. Ky vlerësim ndryshon nëse krahasojmë përgjigjet e OSHC-ve sipas vendodhjes së tyre, ku OSHC jashtë kryeqytetit tentojnë t'i vlerësojnë fushatat në shumicën e rasteve si *disi efektive*.

Ndërkohë vlerësimi i efektivitetit të fushatave analizuar me fushat e veprimtarisë së OSHC-ve, nuk paraqet ndryshime nga vlerësimi i përgjithshëm.


Vlerësimi i efektivitetit të fushatave mbetet po i njëjtë pavarësisht formës së përfshirjes në fushata: si pjesë e një grupimi, në bashkëpunim me një organizatë tjetër apo individualisht.



Ndërkohë, për 32% të OSHC-ve pjesë e vlerësimit të cilat nuk janë përfshirë në fushata advokacie, një ndër arsyt kryesore për mospërfshirje rezultojnë të jetë vështirësia në rrjetëzimin me organizatat e tjera, në 34% të rasteve, ndjekur nga mungesa në kapacitete financiare në 24% të rasteve dhe mungesa e burimeve njerëzore në 22% të rasteve. Marrja e fondeve nga qeveria listohet si një arsye tjetër edhe pse për një numër të pakët të rasteve (3%). Ndërsa për 9% të OSHC-ve advokacia nuk është në fokus të punës së tyre.

Të tjera arsye për mospërfshirje në advokim, listuar nga 9% e OSHC-ve, janë: të qenit një organizatë e re si dhe mos paraqitja e një mundësie të tillë përgjatë kësaj periudhe.

## Nevojat e OSHC-ve për një advokim sa më efektiv\*



Mbështetja financiare, raportohet të jetë nevoja kryesore e OSHC-ve për të patur një advokim sa më efektiv, pavarësisht vendodhjes së tyre, pasuar nga nevoja për burime të dedikuara njerëzore.




## Nevojat për rritje kapacitetesh në advokim

Nevojat e OSHC-ve për zhvillim kapacitetesh në advokim vijojnë të mbeten të njëjta krahasimisht me raportet e kaluara të vlerësimit, ku hartimi i planeve të advokimit, rezulton si nevoja më e lartë në 44 % të rasteve të përgjigjura, pasuar nga nevoja për rritje kapacitetesh në zbatimin e fushatave në 28% të rasteve dhe monitorimin e fushatave të advokimit në 23% të rasteve. 6% e OSHC-ve pohojnë se kanë të tjera nevoja në lidhje me këtë çështje, më së shumti në burime financiare dhe njerëzore si dhe në ndërtimin e partneriteteve.

Kjo renditje ndryshon disi nëse krahasojmë nevojat sipas fushave të veprimtarisë së organizatave. Kështu për OSHC-të që punojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, zbatimi me sukses i fushatave të advokimit rezulton të jetë nevoja më e lartë, ndërkohë OSHC-të në fushën e mbrojtjes dhe shërbimeve sociale listojnë si nevojë parësore për rritje kapacitetesh monitorimin e fushatave të advokimit.

### sipas fushave të veprimtarisë\*



## Çështje të zbatimit të fushatave të advokimit me më shumë interes për rritje kapacitetesh\*


### ↳ sipas vendndodhjes së OSHC-ve

Hartimi dhe shkrimi i një dokumenti politikash (policy paper) vijon të mbetet nevoja më e lartë e OSHC-ve, në aspektin e zbatimit të fushatave të advokimit. Ndërkohë që OSHC-të jashtë kryeqytetit vlerësojnë gjithashtu si po njësoj parësore, nevojën për rritje kapacitetesh në mobilizimin e aktorëve dhe komunitetit.



### ↳ sipas vjetërsisë

Nëse do t'i analizojmë të dhënat, në raport me vitin e themelimit të OSHC-ve, renditja e mëparshme ndryshon disi. Kështu për OSHC-të e themeluara përgjatë viteve 1996-2000, nevoja më e lartë rezulton në zhvillimin e aftësive në komunikim, përgatitje dhe prezantim i mesazhit me palët e interesit, median dhe publikun, ndërkohë për OSHC-të e themeluara përgjatë 2006-2010, mobilizimi i aktorëve mbështetës dhe komunitetit rezulton si nevoja kryesore për rritje kapacitetesh. Për OSHC-të me më shumë eksperiencë 1990-1995, Lobimi me vendimmarrësit është nevoja më e lartë.





## Pjesëmarrja e OSHC-ve në Rrjete/ Koalicione

Pjesëmarrja e OSHC-ve në rrjete/ koalicione apo grupime formale dhe informale vijon të mbetet e konsiderueshme, kjo pavarësisht vendodhjes së tyre (78% e OSHC-ve).



Përfshirja sipas shtrirjes së ushtrimit të veprimtarisë së rrjetit/koalicionit, gjithashtu vijon të mbetet e njëjtë ndër vite, ku rrjetet/koalicioneve që ushtrojnë veprimtari në **nivel kombëtar**, rezultojnë me **përfshirje më të lartë** për 38% të rasteve dhe **rrjetet/koalicioneve në nivel lokal me përfshirje më të ulët** vetëm 13% të rasteve. Pjesëmarrja në rrjete/koalicione në nivel evropian dhe më gjerë rezulton në 25% të rasteve dhe ajo në rrjete/koalicione në rajonin e Ballkanit Perëndimor në 21 % të rasteve.

## Nevojat e OSHC-ve për rritjen e efektivitetit të punës në rrjete/koalicione\*

Pavarësisht përfshirjes së pjesës më të madhe të OSHC-ve në rrjete/koalicione, identifikimi dhe gjetja e partnerëve të përshtatshëm për rrjetëzim, sërish sikurse në vlerësime të shkuara, rezulton si nevoja me interes më të lartë për rritjen e efektivitetit të punës në rrjete/koalicione. Kjo nevojë është deklaruar nga 31% e OSHC-ve pjesë e vlerësimit.

### sipas vjetërsisë\*

Nëse krahasojmë renditjen e këtyre nevojave, në raport me vjetërsinë e OSHC-ve, efektiviteti i punës në rrjete/koalicione (krijimi dhe manaxhimi efektiv i rrjeteve/koalicioneve) paraqitet si sfidë më e lartë për OSHC-të me vjetërsi më të madhe (1990-2005).





## Përfshirja e OSHC-ve në procese konsultimi mbi politika dhe projektligje gjatë vitit 2022-2023\*



Edhe këtë vit, të dhënat e vlerësimit tregojnë se shumica e OSHC-ve kanë qenë të përfshira në procese konsultimi mbi politika dhe projektligje përgjatë 2022-2023. Ndërkohë, nevoja për një përfshirje më të madhe të OSHC-ve jashtë kryeqytetit në procese të tilla, vijon të jetë aktuale, pasi 57% e OSHC-ve pohojnë se NUK kanë qenë pjesë e proceseve konsultuese.

Si arsye kryesore të mospërfshirjes në procese konsultimi, OSHC-të listojnë mungesën e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore dhe financiare. Ky arsyetim mbështetet dhe nga gjetjet e vlerësimit, ku vihet re një diferencë e theksuar në mesataren e punonjësve të OSHC-ve të përfshira në procese konsultimi dhe atyre që nuk janë përfshirë në të tilla procese, respektivisht nga mesatarisht 7 punonjës në 1. Të tjera arsye për mospërfshirje janë dhe mungesa e informacionit mbi procese të tilla si dhe krijimi rishtaz i organizatës apo statusi pasiv i saj.

Sikurse mund të vihet re dhe në grafik, nevoja për përfshirje dhe zhvillim kapacitetesh në këtë drejtim, vijon të mbetet e lartë për OSHC-të e krijuara në tre vitet e fundit.

### sipas fushave të veprimtarisë\*

Përfshirja e OSHC-ve në procese konsultimi, rezulton të jetë e shtrirë në të gjitha fushat e veprimtarisë së OSHC-ve pjesë e vlerësimit, me përfshirjen më të madhe të organizatave që punojnë me të rinjtë dhe fëmijët, organizatave që kanë në fokus mbrojtjen e mjedisit, si dhe atyre që punojnë në fushën e mbrojtjes sociale / shërbimeve sociale.







## Nevojat për rritjen e kapaciteteve lidhur me pjesëmarrjen në proceset konsultuese dhe politikëbërëse\*

Njohja me mekanizmat dhe strukturat e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile, rezulton si nevoja më e raportuar nga OSHC-të për rritje kapacitetesh në lidhje me pjesëmarrjen në procese politikëbërëse, ndjekur nga nevoja për njohje me dokumente strategjike dhe strukturat për bashkëpunim mes organizatave dhe qeverisë.

Ndërkohë nëse analizojmë të dhënat e grumbulluara në raport me vendndodhjen, njohja me format dhe teknikat e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe politikëbërje, si dhe njohja me dokumentet strategjike dhe strukturat për bashkëpunim mes organizatave dhe qeverisë, rezultojnë si nevojat më të mëdha.



### sipas vjetërsisë\*






# PJESËMARRJA E OSHC-VE NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

## Përfshirja dhe angazhimi i OSHC-ve në procesin e integrimit në BE


Rreth 72% e OSHC-ve pjesëmarrëse në vlerësim pohojnë se kanë qenë të përfshirë në procesin e integrimit të vendit në BE.

Pavarësisht përfshirjes, vlerësimi i angazhimit të OSHC-ve, në një shkallë krahasimore nga shumë e angazhuar në aspak e angazhuar, në pjesën më të madhe klasifikohet si *disi e angazhuar*.

Angazhimi i OSHC-ve jashtë kryeqytetit rezulton të jetë më i ulët krahasuar me OSHC-të në kryeqytet, sidomos në klasifikimin si shumë e angazhuar.



## sipas vjetërsisë




Të dhënat tregojnë se kryesisht OSHC-të e krijuara përgjatë 1990-1995 e vlerësojnë veten si *shumë të angazhuar* në këtë proces, krahasuar me OSHC-të e tjera të themeluara më pas.

Numri më i madh i OSHC-ve që nuk janë angazhuar *aspak* në procesin e integrimit në BE, janë OSHC-të e krijuara në tre vjeçarin e fundit.

## sipas fushave të veprimtarisë\*

Përfshirja dhe angazhimi në procesin e integrimit të vendit në BE duket i shtrirë në të gjitha fushat e veprimtarisë së OSHC-ve pjesëmarrëse në vlerësim. Nga të dhënat rezulton se OSHC-të që punojnë në fushën e shërbimeve për personat me nevoja të veçanta dhe në fushën e zhvillimit rural, kanë përfshirjen dhe angazhimin më të ulët në këtë proces.






## Vlerësimi i nivelit të njohurive të OSHC-ve mbi procesin e integrimit të vendit në BE

Të dhënat tregojnë se OSHC-të, pavarësisht vendodhjes së tyre, më së shumti vlerësojnë se niveli i njohurive të tyre mbi procesin e integrimit të vendit në BE, në një shkallë krahasimore nga nuk kemi njohuri, në kemi njohuri shumë të mira, është kryesisht *mesatar*.

Krahasimisht me vitin e kaluar, ka një ulje të numrit të OSHC-ve që raportojnë se kanë njohuri shumë të mira dhe të mira mbi procesin e integrimit. Kjo mund të jetë rrjedhojë e rritjes së ndërgjegjësimit të OSHC-ve mbi kapacitetet e tyre për t'iu përgjigjur procesit të integrimit, në kontekstin edhe të zhvillimeve në këtë drejtim me hapjen e negociatave për anëtarësimin e vendit në BE dhe përfshirjen e OSHC-ve në proces.



## Roli i shoqërisë civile në procesin e integrimit sipas OSHC-ve\*

Këtë vit, OSHC-të pavarësisht fushës së tyre të veprimtarisë, e shohin rolin e shoqërisë civile në procesin e integrimit evropian, më së shumti në dhënien e ekspertizës sipas fushave të tyre përkatëse të kompetencës si dhe në pjesëmarrjen në grupet ndërinstitucionale dhe tryezat e punës për kapitujt, duke ndryshuar krahasimisht me vitet e kaluara ku OSHC-të e shihnin më shumë rolin e tyre në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi procesin e integrimit.




## Pjesëmarrja e OSHC-ve në platforma/struktura të procesit të integrimit

Njohuritë dhe informacioni i OSHC-ve mbi platformat dhe strukturat e procesit të integrimit, vijon të mbetet në të njëjta nivele, pavarësisht vendodhjes së tyre, me 47% të OSHC-ve që raportojnë se nuk kanë informacion dhe 53% të tyre që kanë informacion.

Pavarësisht informacionit, pjesëmarrja e OSHC-ve në platformat apo strukturat e procesit të integrimit evropian, paraqitet **shumë e ulët**, me vetëm 11% të OSHC-ve që raportojnë se janë pjesë e tyre, nga ku 1% janë organizata jashtë kryeqytetit.

Përfshirja në struktura rezulton të jetë më e lartë për organizata që punojnë në fusha si demokracia, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe integrimi evropian, të rinjtë dhe fëmijët, si dhe fuqizimi i gruas dhe çështjet gjinore.

Platformat/strukturat kryesore ku OSHC-të raportojë se marrin pjesë dhe kontribuojnë janë: Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), me përfshirje në tryezat për kapitujt nr.5, 6, 11, 12, 18, 23, 24, 27, 28, 31, si dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian (KKIE).






## Vlerësimi i kapaciteteve për t'u përfshirë në tryeza/grupe me përfaqësues të qeverisë dhe grupeve të interesit gjatë procesit të negociatave për integrimin në BE


Kapacitetet e OSHC-ve për t'u përfshirë në tryeza/grupe pune me përfaqësues të qeverisë dhe grupeve të interesit gjatë procesit të negociatave për integrimin në BE, vijojnë të mbeten në të njëjtat nivele krahasimisht me raportet e kaluara, ku pjesa më e madhe e OSHC-ve, pavarësisht vendodhjes së tyre, raportojnë se kanë *pak kapacitete dhe dëshirojnë t'i zhvillojnë ato më tej*. Ndërkohë vetëm 9% e tyre shprehen se kanë *shumë kapacitete* në këtë drejtim.

Ky raport vlerësimi i kapaciteteve nuk paraqet ndryshime nëse krahasohet me fushën e veprimtarisë së OSHC-ve.



## Si do të dëshironin OSHC-të të angazhoheshin në strukturat e procesit të integrimit\*

Ndarja e informacionit mbi procesin tek grupet e interesit apo komuniteti, si dhe dhënia e rekomandimeve e sugjerimeve institucioneve shtetërore përgjegjëse, janë dy ndër mënyrat kryesore përzgjedhur nga OSHC-të për t'u angazhuar në strukturat e sipërpërmendura.



- Në përcjelljen e shpërndarjen e informacionit mbi procesin tek grupet tuaja të interesit apo komunitetit
- Në monitorimin e ecurisë së reformave dhe procesit
- Në dhënien e rekomandimeve e sugjerimeve institucioneve shtetërore përgjegjëse
- Në dhënien e ekspertizës së drejtpërdrejtë për çështje specifike

## Njohuri dhe aftësi të nevojshme për angazhimin OSHC-ve në procesin e integrimit të vendit në BE

Ndër njohuritë dhe aftësitë më të nevojshme për OSHC-të që të angazhohen dhe përfshihen aktivisht në procesin e integrimit të vendit në Bashkimin Evropian, listohen:


- Njohja e kuadrit ligjor, strukturave dhe mekanizmave të pjesëmarrjes, kryesisht sipas fushave të veprimtarisë së OSHC-ve, në kontekstin e zhvillimeve në procesin e anëtarësimit në BE.
- Zhvillimi i aftësive analitike dhe hulumtuese për monitorim të progresit të reformave dhe prodhimin e raporteve dhe rekomandimeve cilësore ndaj institucioneve shtetërore përgjegjëse.
- Aftësi në adaptimin dhe zbatimin e praktikave të BE-së në kontekstin lokal.
- Rrjetëzim me organizata vendase dhe të huaja që punojnë në të njëjtën fushë, shkëmbim eksperiencash dhe mësim të ndërsjellët në kuadër të proceseve të tilla.
- Rritje kapacitetesh në zhvillimin e fushatave informuese dhe sensibilizuese me target grupet me të cilat OSHC-të punojnë.
- Rritje e kapaciteteve për lobim dhe advokim për të përshpejtuar integrimin në BE dhe për të patur një ndikim më të fortë tek vendimmarrësit përgjatë procesit.




58% e OSHC-ve pohojnë se e ndajnë dhe publikojnë raportin vjetor të aktiviteteve të organizatës. Kjo praktikë rezulton të jetë më e ulët tek OSHC-të jashtë kryeqytetit, të cilat përbëjnë vetëm 38% të OSHC-ve që ndajnë dhe publikojnë raportin vjetor.

Krahasimisht me raporte të tjera vlerësimi, ky nivel publikimi, përkon të jetë i njëjtë me atë të katër viteve më parë.


## Publikimi i raportit vjetor



## Publikimi i raportit vjetor sipas vjetërsisë




## Kanalet e komunikimit ku ndahet raporti vjetor



Website i vetë organizatës, emails/Mailchimp dhe media sociale Facebook rezultojnë tre kanalet më të përdorura për ndarjen dhe publikimin e raportit vjetor sipas OSHC-ve pjesëmarrëse në vlerësim.


## Publikimi i emrave të donatorëve dhe burimeve të financimit të OSHC-së

Të dhënat e vlerësimit tregojnë se OSHC-të kanë një qasje më transparente ndaj publikimit të emrave të donatorëve dhe mbështetësve të tyre, krahasuar me publikimin e burimeve të financimit të tyre.





Në këtë rast media sociale si Facebook vijon të mbetet kanali kryesor për publikimin e emrave të donatorëve dhe mbështetësve të OSHC-ve, pasuar nga website i vetë organizatës.



## Nevojat e OSHC-ve për rritje kapacitetesh për të qenë një organizatë sa më transparente dhe e hapur

Të pyetur se cilat do të ishin disa prej nevojave kryesore të tyre për rritje kapacitetesh për të qenë një organizatë sa më transparente dhe e hapur OSHC-të listojnë rritje kapacitetesh:


- mbi qeverisjen e mirë, llogaridhënien dhe nxitjen e një kulture të hapur komunikimi dhe dialogu me grupet e interesit;
- në hartimin e raporteve vjetore;
- në përdorimin e teknologjisë dhe platformave të hapura për publikimin dhe përfshirjen e publikut e rritjen e transparencës;
- në rishikimin e politikave/procedurave të brendshme për të siguruar transparencën;
- në zhvillimin e sigurisë së informacionit dhe manaxhimit të mediave sociale për komunikim në kohë reale;
- në rrjetëzim dhe krijimin e partneriteteve me OSHC-të për ndarjen e praktikave të mira në këtë drejtim etj.

Një tjetër nevojë e theksuar nga pothuajse të gjitha OSHC-të pjesëmarrëse në vlerësim është rritja e burimeve njerëzore dhe financiare në funksion të përmirësimit të transparencës. Nga analiza e të dhënave të vlerësimit rezulton se, OSHC-të që ndajnë dhe publikojnë raporte vjetore, si një prej mekanizmave të transparencës, kanë një mesatare punonjësish më të lartë, rreth 4 persona, krahasuar me mesataren prej 1,5 person të punësuar për OSHC-të që nuk hartojnë raporte vjetore. Mbështetja financiare kryesisht konsiston në investim në teknologji informacioni në funksion të transparencës si website apo platforma të tjera komunikimi dhe publikimi.




Media lokale vijon të mbetet më e aksesueshme për OSHC-të krahasuar me atë kombëtare, pavarësisht vendodhjes së OSHC-ve.

## Aksesi i OSHC-ve në media




## Aksesi i OSHC-ve jashtë kryeqytetit në media




## Nevojat e OSHC-ve për një bashkëpunimin më efektiv me median në përgjithësi dhe sipas vendndodhjes\*

Zhvillimi i strategjisë / planit të komunikimit me median vijon ende të mbetet nevoja e raportuar më së shumti nga OSHC-të për një bashkëpunim më efektiv me median, me 24% të rasteve, ndjekur nga nevoja për krijimin e mundësive për vendosje kontaktesh me median/gazetarët. Kjo renditje e nevojave të identifikuara, ndryshon disi në raport me vendodhjen e OSHC-ve, ku rritja e kapaciteteve për përdorimin e mjeteve të komunikimit online dhe medias sociale listohet si nevoja më e lartë për OSHC-të jashtë kryeqytetit.



## Kanalet e komunikimit që përdoren më së shumti dhe përditësimi i tyre\*




Mediat sociale vijojnë të mbeten ndër kanalet e komunikimit më të përdorura dhe me frekuencën më të shpeshtë të përditësimit nga OSHC-të edhe përgjatë 2023, ku sërish Facebook rezulton si kanali më i përdorur. Krahasimisht me gjetjet e raporteve të shkuara, përdorimi i platformës Mailchimp dhe LinkedIn, ky i fundit si një prej mediave sociale me profil profesional, kanë pësuar rritje të konsiderueshme, duke u renditur ndër kanalet e komunikimit më të përdorura nga OSHC-të gjatë 2023-it.



## Bashkëpunimi i OSHC-ve me sektorin privat


Krahasimisht me raportet e mëparshme, ka një rritje të konsiderueshme të bashkëpunimit OSHC-Biznes me 58% të OSHC-ve që pohojnë se kanë patur bashkëpunime me sektorin privat. Ky bashkëpunim rezulton më i ulët, tek OSHC jashtë kryeqytetit me 28% të rasteve të bashkëpunimit. Shtrirja gjeografike e bashkëpunimit është e gjerë, duke përfshirë si qytete të mëdha si Tiranë, Shkodër, Vlorë, Durrës, Elbasan, Korçë etj. edhe qytete më të vogla si Fushë-Arrëz, Vau i Dejës, Bulqizë, Fushë Krujë, Përmet, Pukë, Pogradec, Lezhë, Orikum.



## sipas fushave të veprimtarisë\*


Bashkëpunimi i OSHC-ve me sektorin privat ka konsistuar kryesisht në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, ku biznesi ka dhënë kontribut në natyrë (in kind) në 66% të rasteve, ndërkohë që 25% e OSHC-ve kanë raportuar mbështetjen me fonde nga biznesi. 9% e OSHC-ve listojnë forma të tjera bashkëpunimi, duke përfshirë këtu punësim të target grupeve me të cilat ato punojnë, shkëmbim eksperience ndërsektoriale etj.

Bashkëpunimi OSHC-Biznes shtrihet në të gjitha fushat e veprimtarisë së sektorit. OSHC-të që punojnë në fushën e shëndetit dhe kujdesit shëndetësor, rezultojnë të kenë nivel më të lartë bashkëpunimi nëpërmjet mbështetjes me fonde, ndërkohë që OSHC-të në fushën e demokracisë, qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së mjedisit, rezultojnë të kenë bashkëpunimin më të lartë, në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ku biznesi ka dhënë kontribut në natyrë.




## sipas vjetërsisë\*

Nëse do të analizojm bashkëpunimin sipas vjetërsisë së OSHC-ve, ai shtrihet në të gjitha fashat kohore të themelimit të tyre, por qasja më e lartë e bashkëpunimit duket të jetë në OSHC-të e krijuara në dhjetëvjeçarin e fundit.



## sipas buxhetit\*


Ndërkohë, bashkëpunimi sipas buxhetit të OSHC-ve rezulton më i lartë tek ato me buxhet nga 5,000 Eur deri në 100,000 Eur, që përbëjnë mbi 60% të OSHC-ve.





## Njohja e biznesit me OSHC-të dhe veprimtarinë e tyre

88% e OSHC-ve pohojnë se biznesi në qytetin/rajonin e tyre ka dijeni mbi aktivitetin e organizatave. Njohja ka ardhur kryesisht me nismë të OSHC-ve, nga takime të iniciuara/kërkuara nga vetë ato dhe nga takime/evente të përbashkëta të organizuara nga OJF të tjera apo organizata partnere që lehtësojnë krijimin e marrëdhënieve mes sektorëve. Përpjekjet e sektorit privat për të bashkëpunuar me OSHC-të, vijojnë të mbeten në nivele të ulta dhe të njëjtë krahasimisht me gjetjet e raporteve të mëparshme, me vetëm 3% të rasteve të njohjes dhe bashkëpunimit në takime të organizuara nga biznesi në këtë drejtim.



Të pyetur se cilët do të ishin nevojat kryesore për rritje kapacitetesh me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit OSHC-Biznes, OSHC-të kryesisht rendisin:

- hartimin e strategjive efektive të advokimit brenda sektorit privat për më shumë ngritje fondesh dhe mbështetje;
- aftësi dhe strategji për një qasje dhe komunikim më efektiv me sektorin privat;
- teknika efektive të prezantimit të projekt-ideve të tyre (pitching);
- aftësi dhe ekspertizë në zhvillimin e modeleve të qëndrueshme të bashkëpunimit;
- identifikimi i interesave të përbashkëta dhe negocimi i marrëveshjeve;
- përafrimi i shërbimeve të OSHC-ve me nevojat specifike të sektorit privat;
- rritja e njohurive dhe të kuptuarit e strategjive të marketingut social;
- njohuri bazë mbi sektorin privat, ku dhe si operon ai;
- aftësi për të krijuar partneritete efektive;
- përshtatshmëria me zhvillimet teknologjike dhe inovacionin etj.

Më së shumti ajo çfarë identifikohet dhe theksohet vazhdimisht në sugjerimet e OSHC-ve për rritjen e bashkëpunimit, është krijimi i më shumë mundësive për rrjetëzim nëpërmjet aktiviteteve ndërsektoriale, rritja e vizibilitetit dhe ekspozimit të sektorit privat ndaj punës dhe kontributit të OSHC-ve si dhe nevoja për identifikim dhe hartëzim të sektorit privat, nevojave të tij dhe mundësive që ka ose mund të krijojë për më shumë bashkëpunim me sektorin jofitimprurës.



# PËRFUNDIME

## Qeverisja organizative, zhvillimi dhe manaxhimi organizativ:

- Qendrueshmëria financiare vijon të jetë çështja me interes më të lartë në organizatat e shoqërisë civile për rritje kapacitetesh, pavarësisht vendndodhjes apo vjetërsisë së OSHC-ve. Ngritja e fondeve dhe burimet e financimit për OJF-të, si dhe programet e financimit të BE-së, sërish rezultojnë si dy temat më me interes për rritje kapacitetesh në aspektin e qendrueshmërisë financiare të OSHC-ve, qofshin këto OSHC nga kryeqyteti apo jashtë tij.
- Legjislacioni tatimor, detyrimet fiskale dhe raportimi financiar, si dhe procedurat e rimbursimit të TVSH-së vijnë të mbeten çështjet me interes më të lartë për programe të rritjes së kapacitetit mbi kuadrin ligjor dhe atë fiskal, kjo pavarësisht vendndodhjes së organizatave.
- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në çështje të manaxhimit organizativ, monitorimi dhe vlerësimi i programeve/projekteve rezulton si çështja me interesin më të lartë për OSHC-të për rritje kapacitetesh, pasuar nga hartimi i planeve strategjike dhe manaxhimi i burimeve financiare.

## Pjesëmarrja e OSHC-ve në politikëbërje:

- Pjesa më e madhe e OSHC-ve pohojnë se kanë qenë të përfshira në fushata advokacie përgjatë vitit 2023. Kryesisht përfshirja e OSHC-ve rezulton në kuadër të nismave të ndërmarra bashkarisht nga një grupim organizatash, duke shënuar rritje të konsiderueshme krahasimisht me situatën në vitin e kaluar, ku mbizotëronte përfshirja e OSHC-ve në advokaci përmes fushatave zhvilluar nga vetë organizata. Pavarësisht pjesëmarrjes, efektiviteti i fushatave ku OSHC-të kanë marrë pjesë, vlerësohet si *mesatarisht efektive*.
- Vështirësia në rrjetëzimin me organizatat e tjera, vijon të mbetet një ndër arsye kryesore për mospërfshirje nga OSHC-të në fushata advokacie, ndjekur nga mungesa në kapacitete financiare dhe burime njerëzore. Këto dy të fundit, raportohen edhe si dy nevojat kryesore të OSHC-ve për një advokim sa më efektiv.
- Hartimi i planeve të advokimit, mbetet nevojat kryesore për zhvillim kapacitetesh të OSHC-ve në advokim, ku si çështje kryesore në zbatimin e tyre, vijon të mbetet nevoja për rritje kapacitetesh në hartimin dhe shkrimin e një dokumenti politikash (policy paper).
- 78% e OSHC-ve rezultojnë të jenë pjesë e rrjeteve/koalicioneve. Përfshirja më së shumti është në rrjete me shtrirje veprimi kombëtar, pasuar nga ai Evropian dhe rajonal, ndërkohë që përfshirja në rrjete me shtrirje veprimi lokal mbetet në nivele më të ultra. Pavarësisht përfshirjes së lartë të OSHC-ve në rrjete/koalicione, identifikimi dhe gjetja e partnerëve të përshtatshëm për rrjetëzim, vijon të mbetet nevoja më e lartë për rritjen e efektivitetit të punës së rrjeteve/koalicioneve.
- Edhe këtë vit, të dhënat e vlerësimit tregojnë se shumica e OSHC-ve janë përfshirë në procese konsultimi mbi politika dhe projektligje përgjatë 2022-2023. Megjithatë, nevoja për një përfshirje më të madhe të OSHC-ve jashtë kryeqytetit, vijon të jetë aktuale, pasi 57% e tyre pohojnë se NUK kanë qenë pjesë e proceseve konsultuese. Si arsye kryesore të mospërfshirjes në procese konsultimi OSHC-të listojnë mungesën e burimeve njerëzore dhe financiare, pasuar nga mungesa e informacionin mbi procese të tilla.



- Njohja me mekanizmat dhe strukturat e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile dhe me dokumentet strategjike dhe strukturat për bashkëpunim mes organizatave dhe qeverisë, vijojnë të mbeten ende nevojat më të larta të OSHC-ve pavarësisht vendodhjes së tyre, për rritjen e kapaciteteve lidhur me pjesëmarrjen në proceset konsultuese dhe politikëbërëse.

## **Pjesëmarrja e OSHC-ve në procesin e integrimit Evropian:**

- Rreth 72% e OSHC-ve pjesëmarrëse në vlerësim pohojnë se kanë qenë të përfshira në procesin e integrimit të vendit në BE. Pavarësisht përfshirjes, vlerësimi i angazhimit të OSHC-ve, në pjesën më të madhe klasifikohet si disi e angazhuar. Për OSHC-të jashtë kryeqytetit angazhimi në të tilla procese, rezulton të jetë më i ulët krahasuar me OSHC-të në kryeqytet.
- Niveli i njohurive të OSHC-ve mbi procesin e integrimit të vendit në BE, pavarësisht vendodhjes së tyre, rezulton të jetë mesatar, duke pësuar ulje krahasimisht me vitin e shkuar.
- Organizatat e shohin rolin e tyre në kuadër të procesit të integrimit evropian, kryesisht në dhënien e ekspertizës sipas fushave të tyre përkatëse të kompetencës si dhe në pjesëmarrjen në grupet ndërinstitucionale dhe tryezat e punës për kapitujt, duke ndryshuar krahasimisht me vitet e kaluara ku OSHC-të e shihnin më shumë rolin e tyre në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi procesin e integrimit.
- Pavarësisht informacionit, pjesëmarrja e OSHC-ve në platformat apo strukturat e procesit të integrimit evropian, paraqitet shumë i ulët, me vetëm 11% të OSHC-ve që raportojnë se janë pjesë e tyre, nga ku 1% janë OSHC jashtë kryeqytetit.
- Edhe këtë vit, kapacitetet e OSHC-ve për t'u përfshirë në tryeza/grupe pune me përfaqësues të qeverisë dhe grupeve të interesit gjatë procesit të negociatave për integrimin në BE, raportohen nga vetë OSHC-të si të ulta, me dëshirën për tu zhvilluar më tej.
- Ndër njohuritë dhe aftësitë më të nevojshme për OSHC-të që të angazhohen dhe përfshihen aktivisht në procesin e integrimin të vendit në BE, listohen: njohja e kuadrit ligjor, strukturave dhe mekanizmave të pjesëmarrjes në këtë proces; zhvillimi i aftësive në monitorimin e progresit të reformave dhe prodhimin e raporteve dhe rekomandimeve cilësore ndaj institucioneve shtetërore përgjegjës; rrjetëzimi me organizata vendase dhe të huaja që punojnë në të njëjtën fushë; shkëmbim eksperiencash në kuadër të proceseve të tilla; rritje kapacitetesh në zhvillimin e fushatave informuese dhe sensibilizuese me target grupet me të cilat OSHC-të punojnë dhe rritje e kapaciteteve për lobim dhe advokim për të përshpejtuar integrimin në BE dhe një ndikim më të fortë tek vendimmarrësit përgjatë procesit.

## **Transparenca me publikun:**

- 58% e OSHC-ve pohojnë se e ndajnë dhe publikojnë raportin vjetor të aktiviteteve të organizatës. Ky nivel publikimi rezulton të jetë i njëjtë sikurse katër vjet më parë. Kjo praktikë rezulton të jetë më e ulët tek OSHC-të jashtë kryeqytetit.
- Website i vetë organizatës, përdorimi i emails/Mailchimp dhe medias sociale Facebook rezultojnë tre kanalet më të përdorura për ndarjen dhe publikimin e raportit vjetor.



- Të dhënat e vlerësimit tregojnë se OSHC-të kanë një qasje më transparente ndaj publikimit të emrave të donatorëve dhe mbështetësve të tyre, krahasuar me publikimin e burimeve të financimit.
- Rritja e kapaciteve në hartimin dhe shkrimin e raporteve vjetore; përdorimi i teknologjisë dhe platformave të hapura për publikimin dhe përfshirjen e publikut dhe rritjen e transparencës; si dhe rishikimi i politikave/procedurave të brendshme për të siguruar transparencën, janë disa prej nevojave kryesore të OSHC-ve për përmirësimin e transparencës së OSHC-ve ndaj publikut. Një tjetër nevojë e theksuar nga pothuajse të gjitha OSHC-të pjesë e vlerësimit është rritja e burimeve njerëzore dhe financiare në funksion të përmirësimit të transparencës. Mbështetja financiare kryesisht konsiston në investim në teknologji informacioni si website apo platforma të tjera komunikimi dhe publikimi.

### **Bashkëpunimi OSHC - Media:**

- Media lokale vijon të mbetet më e aksesueshme për OSHC-të krahasuar me atë kombëtare, pavarësisht vendodhjes së OSHC-ve.
- Mediat sociale, mbeten ndër kanalet e komunikimit më të përdorura dhe me frekuencën më të shpeshtë të përditësimit nga OSHC-të edhe përgjatë 2023, me Facebook sërish si kanali më i përdorur. Krahasimisht me gjetjet e raporteve të kaluara, përdorimi i platformës Mailchimp dhe LinkedIn, kanë pësuar rritje duke u renditur ndër kanalet e komunikimit më të përdorura nga OSHC-të.
- Zhvillimi i strategjisë / planit të komunikimit me median, vijon të mbetet nevoja e raportuar më së shumti nga OSHC-të për një bashkëpunim më efektiv me median, ndjekur nga nevoja për krijimin e mundësive për vendosje kontaktesh me median/gazetarët.

### **Marrëdhënia me Sektorin Privat:**

- Krahasimisht me raportet e mëparshme, ka një rritje të konsiderueshme të bashkëpunimit OSHC-Biznes me 58% të OSHC-ve që pohojnë se kanë patur bashkëpunime me sektorin privat. Ky bashkëpunim rezulton më i ulët, jashtë kryeqytetit me vetëm 28% të OSHC-ve.
- Bashkëpunimi me sektorin privat ka konsistuar kryesisht në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ku biznesi ka dhënë kontribut in kind në 66% të rasteve, mbështetje me fonde në 25% të rasteve. 9% e OSHC-ve listojnë forma të tjera bashkëpunimi duke përfshirë këtu punësim të target grupeve me të cilat ato punojnë, shkëmbim eksperience ndërsektoriale etj.
- Bashkëpunimi OSHC-Biznes shtrihet në të gjitha fushat e veprimtarisë së sektorit dhe në fashat kohore të themelimit të tyre, por qasja më e lartë e bashkëpunimit duket të jetë në OSHC-të e krijuara në dhjetëvjeçarin e fundit.
- Pjesa më e madhe e OSHC-ve vlerësojnë se bizneset në qytetin/rajonin e tyre kanë dijeni mbi aktivitetin e organizatave. Njohja OSHC-Biznes kryesisht ka ardhur me nismë të OSHC-ve, nga takime të kërkuara nga vetë OSHC-të si dhe nga takime dhe evente të përbashkëta organizuar nga OJF të tjera apo organizata partnere që lehtësojnë krijimin e marrëdhënieve mes sektorëve. Përpjekjet e sektorit privat për të bashkëpunuar me OSHC-të, vijnë të mbeten në nivele të ulta dhe të njëjtë, krahasimisht me gjetjet e raporteve të mëparshme.
- Pavarësisht njohjes, OSHC-të mendojnë se ka ende nevojë për më shumë rrjetëzim nëpërmjet aktiviteteve ndërsektoriale, rritje të vizibilitetit dhe ekspozimit të sektorit privat ndaj punës dhe kontributit të OSHC-ve si dhe nevojë për identifikim dhe hartëzim të sektorit privat, nevojave të tij dhe mundësive që ka ose mund të krijojë për më shumë bashkëpunim me sektorin jofitimprurës.



